



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1181

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Kryetare, Isa Hasani Anëtar dhe Vedat Poterqoi Anëtar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Zgjerimi dhe rregullimi i rrugës Tranziti i qytetit me numër të prokurimit 632-24-8521-5-1-1, me 03.02.2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K., me nr. 2024/1181, e datës 05.12.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit Zgjerimi dhe rregullimi i rrugës Tranziti i qytetit me numër të prokurimit 632-24-8521-5-1-1.
2. Mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin (B58) lidhur me aktivitetin e prokurimit
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 23.08.2024 KOMUNA E GJAKOVËS., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi dhe rregullimi i rrugës Tranziti i qytetit me numër të prokurimit 632-24-8521-5-1-1.

Me 18.11.2024, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftimi mbi vendimin (B58) ku ka shpërblyer me kontratë Grupin i Operatorëve Ekonomik „Lika Trade Sh.p.k.; Lika Company SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur, me llojin e kontratës punë me vlerë të kontratës 5,711,987.90 euro.

Me 25.11.2024 OE JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Ku Autoriteti Kontraktues me 27.11.2024 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 05.12.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K., me numër protokolli 2024/1181 lidhur me aktivitetin e prokurimit Zgjerimi dhe rregullimi i rrugës Tranziti i qytetit me numër të prokurimit 632-24-8521-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K., janë parashtruar si në vijim: "Ne jemi eliminuar nga procesi i tenderit me arsyetimin se pajisja Gjysëm-rimorkio për bartjen e makinave të rënda ka një peshë prej 105 ton, që është më e madhe se ajo që kërkohej. Kjo arsye është e paqëndrueshme, pasi në kërkesën e dosjes së tenderit ishte specifikuar që pajisja duhet të ketë një kapacitet minimal prej 75 ton dhe maksimal 90 ton. Në përputhje me këtë, ne kemi prezantuar pajisjen me një kapacitet të peshës 86.3 ton, që është brenda kufijve të kërkuar. Për më tepër, nuk është specifikuar pesha totale e pajisjes dhe ne e kemi paraqitur kapacitetin e peshës siç është kërkuar, duke përmbushur kështu kërkesën e dosjes së tenderit dhe duke treguar se arsyeja për eliminimin tonë është e paqëndrueshme. Po ashtu, AK-ja ka theksuar se nuk e kemi paraqitur grejderin sipas kërkesës së dosjes së tenderit, duke arsyetuar se grejderi ka një laser të veçantë të jashtëm, ndërkohë që kërkohej që grejderi të ishte i pajisur me një laser digjital. Kjo arsye është gjithashtu e paqëndrueshme. Kërkesa e dosjes së tenderit specifikonte që grejderi duhet të jetë i pajisur me një ripper dhe laser digjital për nivelimin e rrugëve, dhe ne kemi prezantuar një sistem laser i cili është i montuar në grejder, siç kërkohej. Pra, grejderi është në përputhje me kërkesat, dhe arsyeja për eliminimin tonë është e pabazuar. Gjithashtu, jemi eliminuar për shkak të një pretendimi se nuk kemi plotësuar kërkesën për dy prerëse të asfaltit. AK-ja argumentoi se nuk është dëshmuar pronësia e pajisjeve nga shitësit, përfshirë faktin që noteri ka vërtetuar vetëm vërtetësinë e nënshkrimit, por jo edhe pronësinë. Ky pretendim është i paqëndrueshëm, pasi ne kemi paraqitur një kontratë shitblerjeje të vërtetuar tek noteri për këto pajisje. Duket se këto makineri janë blerë nga persona fizikë dhe vlera e tyre është nën 500.00, prandaj nuk janë lëshuar fatura apo pagesa përmes bankës. Ne kemi paraqitur dëshmi të qarta dhe konkrete që dëshmojnë se i posedojmë këto pajisje, dhe nuk mund të eliminohejmë me një arsye të tillë. Përsa i përket çështjes së certifikatave ISO, AK-ja ka pretenduar se certifikatat që kemi paraqitur kishin një përputhje të paqartë të datës së lëshimit, duke theksuar ndryshimet në data në faqen e internetit të sistemit të certifikimit. Kjo arsye është e paqëndrueshme pasi ne kemi shpjeguar dhe vërtetuar që certifikatat janë të vlefshme dhe të publikuara në faqen zyrtare. Sqaruam gjithashtu se ndryshimet në datat e publikuara në faqen e internetit janë çështje të kompanisë që lëshon certifikatat dhe se çdo dyshim i mundshëm duhet të

ishte adresuar direkt me atë kompani. Dëshmia e vlefshmërisë e certifikatave është vërtetuar nga vetë AK-ja, dhe si pasojë, arsyetja për eliminimin tonë është e pabazuar. Për më tepër, kemi hasur në një situatë ku është rekomanduar për kontratë një operator ekonomik (OE) që nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për kualifikimin e inxhinierëve. Ata kanë prezantuar një inxhinier që nuk përmbushte kërkesën për të qenë master në inxhinieri mekanike, por ishte vetëm një bachelor i inxhinierisë mekanike. Kjo është një shkelje e kërkesave të tenderit, pasi kërkohej një inxhinier me master në fushën përkatëse. Po ashtu, edhe në lidhje me kërkesat për inxhinierët e fushës elektrike dhe kompjuterike, OE i rekomanduar ka paraqitur një inxhinier që nuk përmbushte kërkesat për të qenë i diplomuar në këtë fushë specifike. Në lidhje me kërkesën për licencën për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit, OE i rekomanduar ka paraqitur një licencë që nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, pasi ato janë për sortues dhe shkëmb-gurë i fortë dhe jo për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit. Kjo ka shkelur kërkesat dhe OE i rekomanduar për kontratë ka pasur një dokumentacion të papërshtatshëm. Diferenca e çmimit midis ofertës sonë dhe ofertës së OE të rekomanduar për kontratë është 438,541.50 €, duke e bërë më të shtrenjtë ofertën e OE të rekomanduar, ndërsa ne kemi ofertuar me një çmim shumë më të ulët dhe të arsyeshëm. Gjithashtu, kemi dyshime të forta për mundësinë e një kurdisjeje të tenderit, pasi kemi hasur në të njëjtën dosje tenderi në katër tenderë të ndryshëm dhe kërkesat duket se janë përshtatur për OE të rekomanduar për kontratë. Në këtë kuadër, kërkesa jonë për rishqyrtim është refuzuar pa një arsyetim të qartë, dhe në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim nuk është dhënë asnjë argument konkret, duke treguar një mangësi në transparencë dhe barazi. Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me ligjin, duke mos arsyetuar si duhet refuzimin e kërkesave tona dhe duke favorizuar OE të rekomanduar për kontratë. Kjo është një shkelje e drejtëpërdrejtë e ligjit të prokurimit publik dhe e mundësisë për të siguruar përdorimin më efikas të fondeve publike, duke mos respektuar kriterin kryesor për dhënie të kontratës, që është tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët"

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: "Operatori Ekonomik "JCOS & KRASNIQI - BAZE", më datë 25.11.2024, ka parashtuar kërkesë për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi dhe rregullimi i rrugës Tranziti i qytetit", Nr. i prokurimit - 632-24-8521-5-2-1, Nr. i brendshëm - 632-24-104-521. Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjakovës, më datë 27.11.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë: Pas rishikimit të pretendimeve tuaja lidhur me ofertën tuaj, Autoriteti kontraktues konsideron se ato janë të pabazuara dhe qëndron pranë vendimit të tij. Sa i përket pretendimeve tuaja për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë, sqarojmë se pretendimet e juaja janë të pabazuara dhe Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë i plotësohen kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT."

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 06.12.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/1181, ndërsa me datë 16.12.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues dhe teknik me nr. 2024/1181, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që *ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK– Komuna e Gjakovës në pajtim me nenin 72 të LPP-së të bëjë sqarimet e duhura.*

Lidhur me pretendimet e JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1181 ka vlerësuar si në vijim: "1. PËRSHKRIMI I ANKESËS

Krasniqi - Baze SH.P.K. ka parashtruar ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës, për eliminimin e ofertës së tyre në projektin “Zgjerimi dhe rregullimi i rrugës Tranziti i qytetit” dhe rekomandimin për dhënie të kontratës të grupit të operatorëve ekonomik “Lika Trade” SH.P.K. & Lika Company SH.P.K.”. Ankuesi kërkon nga OSHP-ja që lënda të kthehet në rivlerësim në mënyrë që të sigurohet trajtim i barabartë dhe i të drejtë i ofertave, duke u bazuar në shkeljet e Ligjit për Prokurim Publik (LPP) që janë bërë gjatë procedurës.

2. PRETENDIMET ANKIMORE "Operatori pretendon se elimini i tyre nga gara është bërë me arsye të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Pikat kryesore të cilat kundërshtohen nga Joos & Krasniqi - Baze SH.P.K. janë si në vijim: Kontratat dhe referencat e dorëzuara: Operatori ekonomik ankues pretendon se ka dorëzuar të gjitha dëshmitë e nevojshme që përmbushin kriteret e tenderit, përfshirë listat e kontratave të përfunduara me sukses dhe referencat për projektet e ngjashme. Sipas OE ankues pretendimi i AK-së se disa kontrata nuk janë përfunduar ose nuk përmbushin kriteret për vlerën minimale prej 8,500,000.00 € është i gabuar. Si dëshmi, në ankesën drejtuar OSHP-së, ankuesi ka bashkëngjitur referenca, procesverbale të pranimit teknik dhe situacione financiare për projektet e realizuara. Kualifikimet e stafit teknik: Joos & Krasniqi - Baze SH.P.K. pretendon se plotëson kërkesën e FDT-së sa i përket Inxhinierit të diplomuar të Ndërtimitarisë apo Master në Inxhinierinë Mekanike, drejtimi i Termoenergjisë dhe Energji të Ripërtëritshme me 3 vite përvojë pune. AK-ja në letrën standarde për eliminim pretendon se drejtimi i diplomës së Inxhinierit nuk përputhet me kërkesat në FDT, por operatori ankues në ankesën drejtuar OSHP-së thekson se kërkesat për drejtimin specifik ka qenë e paqartë dhe ka lejuar përfshirjen edhe të inxhinierëve të ndërtimit. Gabimet teknike në dokumentacion: AK-ja eliminoi ofertën edhe për gabime teknike në dokumentet e menaxherit të projektit dhe udhëheqësit të punishtes (si adresimi i gabuar i një komune tjetër). Ankuesi pranon se në rastin e dokumenteve për menaxherin e projektit dhe udhëheqësin e punishtes, ka pasur disa gabime teknike (si përdorimi i emrit të një komune tjetër), por këto janë thjesht lëshime të vogla dhe nuk ndikojnë në përmbajtjen dhe vlefshmërinë e ofertës. Makineritë dhe pajisjet: Operatori i kundërshton pretendimet e AK-së për pajisjet dhe makineritë e dorëzuara, duke argumentuar se grejderët dhe gjysmë-rimorkiot plotësojnë kërkesat teknike të tenderit. Certifikatat ISO: Certifikatat e dorëzuara janë të vlefshme dhe të publikuara në faqet zyrtare të organeve lëshuese. Ankuesi gjithashtu thekson se AK-ja mund të kishte bërë verifikime të mëtijshme për të konfirmuar vlefshmërinë para eliminimit të tyre. Operatori ekonomik ankues po ashtu pretendon se grupi i operatoreve ekonomik “Lika Trade” SH.P.K. & Lika Company SH.P.K.”, i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk kanë përmbushur kërkesat e tenderit/njoftimit për kontratë dhe se përzgjedhja ka qenë e padrejtë. Pikat kryesore të cilat OE ankues pretendon se nuk janë plotësuar nga grupi i operatorëve të rekomanduar për dhënie të kontratës janë si në vijim: Çmimi i lartë i ofertës: Oferta fituese ishte 5,691,318.69 €, që është 438,541.50 € më e lartë se oferta e ankuesit prej 5,252,777.19 €. Ankuesi argumenton se ky vendim bie në kundërshtim me nenin 60 të LPP-së, i cili përcakton që kontrata t'i jepet ofertës më të ulët dhe më të përgjegjshme. Mospërputhja me kriteret teknike dhe profesionale: Kualifikimet e inxhinierëve: Sipas OE ankues grupi fitues ka prezantuar disa inxhinier me kualifikime që nuk përputhen me kërkesat e tenderit. Licencat: Licencat për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit të dorëzuara nga grupi fitues ankuesi pretendon se nuk përputhen me kërkesat e tenderit. Favorizim dhe parregullsi: Ankuesi pretendon se nisur nga inicimi i procedurës së prokurimit, pastaj vazhduar me procesin e vlerësimit, AK ka favorizuar padrejtësisht grupin fitues.

3. KËRKESAT E OE ANKUES Për shkak të shkeljeve të pretenduara të Ligjit për Prokurim Publik (LPP), Joos & Krasniqi - Baze SH.P.K. kërkon: Anulimin e vendimit të AK-së për shpalljen e fituesit dhe eliminimin e ofertës së tyre. Rivlerësimin e ofertave në përputhje me parimet e LPP-së dhe kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit. Kompensimin për dëmet materiale të shkaktuara gjatë procesit të tenderimit, si dhe për shpenzimet e ankesës.

4. ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES Eksperti shqyrtues ka shqyrtuar në detaje pretendimet ankimore të operatorit ekonomik Joos & Krasniqi - Baze sh.p.k., duke analizuar nëse ato janë në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK) dhe me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Analiza ka nxjerrë në pah të gjeturat si në vijim: 4.1. Kontratat dhe referencat Me një qasje të kujdesshme, eksperti shqyrtues ka vlerësuar listën e kontratave të dorëzuara për të verifikuar nëse Joos & Krasniqi - Baze sh.p.k. ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme gjatë tre viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë), në një vlerë prej jo më pak se 8,500,000.00 €. Nga analiza kanë dalë këto të gjetura: Kontrata numër 2 ka një referencë të datës 20.12.2021, por mungon data e përfundimit të kontratës. Në kontratën e dorëzuar e cila është nënshkruar në vitin 2017 thuhet se projekti përfundon në vitin 2018. Kontrata nuk ka përfunduar sipas periudhës së kërkuar nga AK-ja. Kontrata numër 3 ka një referencë të datës 16.12.2021, por gjithashtu mungon data e përfundimit, e cila është thelbësore për të konfirmuar se kontrata është përfunduar brenda periudhës së kërkuar. Në kontratë thuhet: Projekti është planifikuar të realizohet në vitet 2018/2019. Kontrata nuk ka përfunduar sipas periudhës së kërkuar nga AK-ja. Kontrata numër 5 është nënshkruar sipas listës me datë 28.05.2019, por ka një procesverbal të pranimit teknik të punëve të kryera me datën 22.12.2021. Kontrata numër 7 është nënshkruar me datë 08.11.2018 me vlerë prej 333,792.32 €, ndërsa amendamenti i punëve shtesë prej 31,630.00 € është nënshkruar me datë 10.12.2019 dhe afati kohor i përfundimit është përcaktuar 30 ditë pune. Në referencë thuhet se punët kanë përfunduar me datë 17.09.2020 në vlerë prej 320,332.86 €. Kontrata nuk ka përfunduar sipas periudhës së kërkuar nga AK-ja. Kontrata numër 12 është nënshkruar me datë 12.02.2018 në vlerë prej 11,913,157.91 €, ndërsa amendamenti është bërë me 26.06.2019 në vlerë prej 948,653.12 €. Afati kohor i përfundimit të punëve shtesë është përcaktuar të jetë 60 ditë kalendarike. Kontrata nuk është e përfunduar, është bërë vetëm një pranim i pjesshëm dhe si e tillë nuk e plotëson kërkesën e AK-së. Edhe në referencë potencohet se është bërë pranim teknik i pjesshëm.

Mbështetur në argumentet e lartcekura eksperti shqyrtues kontakton se lista e kontratave e dorëzuar nga OE - Joos & Krasniqi - Baze sh.p.k. nuk plotëson kërkesën e AK-së. Disa kontrata nuk përputhen me periudhën e kërkuar nga AK-ja, pasi data e përfundimit të tyre nuk konfirmon realizimin brenda periudhës së përcaktuar.

4.2 Staf i profesional AK në kërkesën në njoftimi për kontratë /dosje të tenderit ka kërkuar si në vijim:

e.) Një (1) inxhinier i diplomuar - ndërtimtarisë apo master ne Inxhinierinë Mekanike, drejtimi Termoenergjetike dhe Energji të Ripërtëritshme me 3 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. Sipas analizës së ekspertit shqyrtues, OE ankues ka paraqitur dy inxhinier: Arbëreshe Kastrati, ka ofruar diplomë të masterit në inxhinieri ndërtimi, profili Strukturist. Kualifikimi nuk përputhet plotësisht me kërkesën e tenderit të AK-së. Mustafa Shema, ka diplomë në inxhinieri mekanike, por ky kualifikim nuk përputhet plotësisht me kërkesën e tenderit sepse drejtimi nuk është i njëjti me atë që është kërkuar nga AK-ja. Inxhinierët e paraqitur nga OE ankues nuk kanë

kualifikimet specifike për drejtimin “Termoenergjetikë dhe Energji të Ripërtritshme”. Ndërsa sa i përket çështjes se AK në kërkesën në FTD ka lënë dy mundësi të aplikimit. Mundësia e parë inxhinier i diplomuar- ndërtimtarisë apo master ne Inxhinierinë Mekanike, drejtimi Termoenergjetike dhe Energji të Ripërtërishme, eksperti shqyrtues sqaron se gjatë fazës së përgatitjes së tenderit OE ankues në pajtim me nenin 53 të LPP-së ka mundur të kërkojë informacion shtesë dhe të qartësojë këtë çështje.

4.3 Gabimet Teknike në Dokumentacion Një prej arsyeve të eliminimit të ofertës së operatorit ekonomik ankues nga gara ka qenë për disa gabime teknike në dokumentacion. Më konkretisht: Menaxheri i projektit dhe udhëheqësi i punishtes kishin dokumente që përmbanin gabime, si përdorimi i emrit të një komune tjetër (Komuna e Junikut në vend të Komunës së Gjakovës). OE ankues pretendon se ky ishte një lëshim teknik që nuk mund të konsiderohej si një gabim që ndikon në përmbajtjen dhe vlefshmërinë e ofertës, pasi informacioni esencial ishte i saktë sepse kur analizohet vendimi në të cilin figuron titulli i projekti dhe numri i prokurimit dhe ndërlidhja me komuna të tjera mund të përkufizohej si gabim material dhe jo një shkelje të rëndë të kërkesave të tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron se, OE nuk ka ofertuar sipas kërkesës së AK-së. Të dy vendimet pavarësisht titullit të projektit dhe numrit të prokurimit i referohen një institucioni tjetër. Megjithatë eksperti shqyrtues sqaron se, në rast se oferta e OE ankues do të ishte e përgjegjshme AK mund ta konsideronte devijim të vogël pretendimin ankimor të lartcekur.

4.4 Plani dinamik AK ka vënë në dyshim dorëzimin e planit dinamik të punimeve, duke argumentuar se ai duhej të ishte nënshkruar nga menaxheri i projektit dhe udhëheqësi i punishtes. Në arsyet mbi eliminim thuhet se plani dinamik është nënshkruar nga Z. Agron Krasniqi (drejtor i kompanisë), ndërsa AK ka kërkuar që Plani dinamik për kryerjen e punimeve duhet të jetë i punuar në forme të detajuara nga menaxheri i projektit dhe udhëheqësi i vend-punishtes (të cilët përcaktohen nga ofertuesi me vendim).

Eksperti shqyrtues pas analizimit të dokumenteve ka vërejtur se, OE nuk ka dorëzuar Planin dinamik sipas kërkesës së AK-së. Plani i dorëzuar nuk është nënshkruar nga menaxheri i projektit dhe udhëheqësi i vend-punishtes.

4.5. Makineritë dhe Pajisjet Një tjetër pjesë kyçe e ofertës ishte paraqitja e makinerive dhe pajisjeve, të cilat duhet të përmbushnin kërkesat teknike të specifikuara në FDT. Eksperti shqyrtues sqaron se oferta e OE ankues është përcjellë me disa devijime. Pajisjet të cilat janë vënë në dyshim nga AK-ja e të cilat janë kontestuar nga OE ankues janë: Pajisja nr.2. Kërkesa e AK-së: Gjysmë-rimorkio për bartjen e automjeteve të rënda me peshe min. 75 maksimum 90 ton, Gjysmë-rimorkio duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit). OE ka ofertuar me: Gjysmë-rimorkio për bartjen e makinave të rënda, Marka: ES GE, Modeli: SATTELTIRFLADER, Targat: OO-426VR, Nr. Shasis: W09GLN815DEE32462, Ngarkesa: 86300 (Marrëveshje me qira “VIJATOR D.O.O). Pajisje është ofruar me masë 18700 dhe ngarkesë 86300. AK në njoftimin mbi eliminim ka potencuar se OE nuk plotëson kërkesën e AK-së sepse është kërkuar që gjysmë-rimorkio të ketë peshë min. 75 – 90 ton, ndërsa pajisja e ofruar ka peshë 105 ton. Sipas AK, OE ka aluduar në peshën e bartjes ku ka theksuar se gjysmë rimorkio e prezantuar ka kapacitet të peshës për bartje 86.3 ton. Pas analizimit të dokumenteve të tenderit eksperti shqyrtues vlerëson se, pajisja e ofruar nuk plotëson kërkesën e AK-së. Pajisja nr.18. Kërkesa e AK-së: Grejder të pajisur me rrjepës (ripper) dhe laser digjital për nivelimin e rrugëve me peshë min. 18t maksimum 20.5 ton. OE ka ofruar: Grejder të pajisur me

rrjepës (ripper) dhe laser digjital për nivelimin e rrugëve me peshë min. 18t maksimum 20.5 ton. 1.Rrafshuese dhe i perdorur- Greder, Marka: CATERPILLAR, Tip: 143H, Peshë: 19000kg, VP: 2001, Nr shasis: 1AL01127 (Marrëveshje me qira KAG Asphalt SH.P.K). 2.Rrafshuese dhe i përdorur - Greder, Marka: HBM-NOBAS BG 190 TA-4, Peshë: 19000kg, VP: 2021, Nr shasis: 420412 (Marrëveshje me qira PZPVALJEVO AD). AK në arsyetimin mbi eliminim ka potencuar se AK ka kërkuar grejder të pajisur me laser, ndërsa OE ka ofruar grejder por me laser të veçantë. Pra sipas AK-së grejderi i ofruar nuk plotëson kërkesën e AK-së sepse pajisja laser është ofruar si e veçantë. Eksperti shqyrtues pas analizimit të dokumenteve të tenderit konteston se pajisja e ofruar nuk përmbush kërkesën e AK-së. Eksperti shqyrtues po ashtu sqaron se, në këtë fazë nuk mund të lëshohet në konstatime nëse pajisja e ofruar mund të pranohej edhe si e tillë, kjo marrë parasysh fazën në të cilën ndodhet procedura e prokurimit. Pajisja nr.38. Prerëse e asfaltit - OE ka ofruar: 1.Motorr për prerjen e Asfaltit, Marka: WACKER, Pronesi: Joos&Krasniqi-Bazë Sh.p.k. 2.Prerëse e Asfaltit, Marka STIHL 664, Viti I prodhimit 1998, Pronesi: Joos&Krasniqi-Bazë Sh.p.k. Si dëshmi përcjellëse OE ka ofruar kontratat mbi shitblerjet të noterizuara dhe të përcjella me dy foto. OE në kërkesën për sqarim të tenderit ka argumentuar se makineritë janë blerë nga persona fizik dhe vlera e tyre është më e ulët se 500 euro dhe ka qenë e pamundur të lëshohet faturë nëpërmjet bankës. OE nuk ka ofertuar sipas kërkesës së AK-së.

Sa i përket makinerive të kontestuara nga AK e për të cilat OE ankues pretendon se kanë pas dykuptimësi në kërkesat e vendosura në FDT eksperti shqyrtues sqaron se, edhe gjatë fazës së përgatitjes së tenderit OE ankues në pajtim me nenin 53 të LPP-së ka mundur të kërkojë informacion shtesë dhe të qartësojë këtë çështje.

4.6 Certifikatat ISO Autoriteti Kontraktues ka vënë në dyshim vlefshmërinë e certifikatave të dorëzuara nga operatori ankues, duke pretenduar se datat e lëshimit të certifikatave nuk përputhen me ato që janë regjistruar në faqet e internetit të autoriteteve përkatëse.

Eksperti shqyrtues pas analizimit të dokumenteve të tenderit sqaron se, datat e certifikatave të dorëzuara nuk përputhen me atë të faqës së internetit nga autoriteti që i ka lëshuar ato, megjithatë në përputhje me nenin 59-72 të LPP-së, AK mund të kishte kërkuar një verifikim të mëtejshëm të këtyre certifikatave (tek autoriteti i cili i ka lëshuar këto) para se të merrte vendimin për eliminim.

4.7 Oferta e grupit të rekomanduar për dhënie të kontratës Operatori ekonomik Joos & Krasniqi - Baze SH.P.K., pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës është i papërgjegjshëm në kërkesat si në vijim:

4.7.1 Stafit Profesional: Joos & Krasniqi - Baze SH.P.K., pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk plotëson kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional për stafin profesional si në viim: e) Një (1) inxhinier i diplomuar- ndërtimtarisë apo master ne Inxhinierinë Mekanike, drejtimi Termoenergjetike dhe Energji të Ripërtëritshme me 3 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.ë). Një (1) inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë apo master i diplomuar) ne Inxhinierinë Elektrike dhe Kompjuterike, me 3 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.Ç.) Një (1)) inxhinier i diplomuar- makinerisë apo master makinerisë -drejtimi Komunikacion (ose Transport dhe Trafik) me 3 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit ose inxhinier i nivelit bachelor me 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka realizuar së paku dy (2) projekte në ndërtimin e rrugëve te kategorisë me 4 apo më shumë shirita të trafikut rrugor.

Sa i përket pretendimit ankimor të lartcekur eksperti shqyrtues pas analizimit të dokumenteve të tenderit sqaron si në vijim: e) Dardan Krasniqi – është ofruar baceler i Inxhinierisë mekanike dhe certifikata e përfundimit të studimeve master i Shkencave në programin Sistemet e Energjisë së Rinovueshme. Plotëson kërkesën e AK-së. ë) Bekim Beqiri – bart titullin Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës, ndërsa kërkesa e AK-së ka qenë Një (1) inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë apo master i diplomuar në Inxhinierinë Elektrike dhe Kompjuterike. Eksperti shqyrtues sqaron se diploma e dorëzuar nuk figuron të jetë diplomë baceler e sistemit të Bolonjës që nënkupton se është diplomë e para sistemit të Bolonjës (Ekuivalent me master). Krahasueshmëria dhe barasvlera e diplomave dhe e programeve studimore para sistemit të Bolonjës dhe të sistemit të Bolonjës është e rregulluar me “UA- (MASHT) Nr. 11”. ç) Hekuran Ukaj – është ofruar baceler i komunikacionit rrugor dhe transportit. Kërkesa e AK-së ka qenë një (1) inxhinier i diplomuar-makinerisë apo master makinerisë -drejtimi Komunikacion (ose Transport dhe Trafik) me 3 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit ose inxhinier i nivelit baceler me 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. Eksperti shqyrtues konstaton se OE plotëson kërkesën e AK-së duke pas parasysh se në kërkesë AK ka pohuar se mund të ofertohet dhe me inxhinier të nivelit baceler.

4.7.2 Licencë valide nga KPMM-ja: Operatori ekonomik Joos & Krasniqi - Baze SH.P.K. pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofruar dëshmi se është i pajisur me licencë valide nga KPMM-ja ose kontratë nga një ndërmarrje e licencuar nga KPMM-ja për shfrytëzimin të rërës dhe zhavorrit. Dëshmitë e ofruara: Pas analizimit të dokumenteve të tenderit eksperti shqyrtues konstaton se grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës nuk kanë ofruar dëshmi se janë të pajisur me licencë valide nga KPMM-ja për shfrytëzimin të rërës dhe zhavorrit. Qartësimi i licencave është e rregulluar nën 10.1 të Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik dhe në pajtim me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së, AK mund të kërkojë sqarim të tenderit. 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve 10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veprojë në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së:

4.7.3 Përshtatja e tenderit Sa i përket pretendimit ankimor në lidhje me kurdisjen e tenderit gjatë fazës së tenderimit, eksperti shqyrtues nuk mund të lëshohet në komentim apo ndonjë rekomandim për shkak se aktiviteti i prokurimit tashmë ndodhet në një fazë tjetër.

4.7.4 Çmimi i lartë i ofertës Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor lidhur me atë se oferta e ankuesit është më çmim më të lirë, eksperti shqyrtues sqaron se, në pajtim me nenin 60 të LPP-së AK është i obliguar t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME Pas analizës së pretendimeve të OE ankues dhe dokumentacionit të tenderit, eksperti shqyrtues sqaron si në vijim: Oferta e OE ankues është e papërgjegjshme: Sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues në lidhje me eliminim e tyre nga gara, eksperti shqyrtues konstaton se disa nga dokumentet kanë mundur të verifikohen (ISO Standardet), megjithatë nga të gjeturat e lartcekura oferta e OE ankues është e papërgjegjshme. Rivlerësimi i ofertave: Lënda të kthehet për rivlerësim, dhe AK– Komuna e Gjakovës në pajtim me nenin 72 të LPP-së të bëjë sqarimet e duhura dhe vlerësimin ta bëjë në pajtim me nenin 59 të LPP-së dhe Nenin 40 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Zgjerimi dhe rregullimi i rrugës Tranziti i qytetit me numër të prokurimit 632-24-8521-5-1-1.

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli shqyrtues gjatë ekzaminimit të dokumentacionit verën se OE ankues nuk i ka paraqitur kontratat përkatëse në përputhje me kërkesën e DT, këtë pretendim e ka mbështetur edhe eksperti në raportin e tij, duke krijuar një mosperputhje në lidhje me dokumentacionin e kërkuar në DT. Po ashtu, lidhur me këtë ekziston edhe opinioni i KRPP nr.11 i publikuar me dt. 09.06.2023, i cili ndër tjera thekson se "**Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme".

Po ashtu Paneli Shqyrtues konstaton se OE ankues nuk e ka dorezuar Planin dinamik të punës ne perputhje me DT, i cili është një element kyç për mbikëqyrjen e projektit, nuk e ka të nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe Udhëheqësi i Punishtes, siç kërkohet nga standardet dhe procedurat e përcaktuara në kontratë, kete pretendim ankimor edhe eksperti ne raportin e tij e ka cilesuar si te tillë.

Sa i perkete pretendimit ankimor lidhur me pajisjet e kerkuara ne DT, PSH konstaton se OE pajisjeve qe jane listuar nuk janë në përputhje me specifikimet e kërkuara në DT, çka tregon një mosrespektim të kërkesave të përcaktuara në dokumentacionin e kontratës.

PSH në lidhje me rekomandimin e parashtruar lidhur lejen për rërë dhe zhavorr, konstaton se kjo leje është dhënë përmes një marrëveshje me kompaninë "Haxha Company," e cila është e licencuar për shpërndarje të materialeve si shkëmbi i fortë. Ndërkohë që ky aktivitet mbulohet nga leja për gurëthuesit, pasi lënda e përdorur është në përputhje me licencën që është e vlefshme për veprimtarinë e shfrytëzimit të këtyre materialeve. Gjithashtu, në bazë të informacionit të ofruar nga AK, OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet që janë paraqitur nga DT, duke plotësuar kështu kushtet e nevojshme. Per Panelin shqyrtues kjo mund te mirret si e mireqene, kur dihet mire se vleresimin e ofertave AK duhet ta beje konform kerkesave te DT, konform nenit 59.4 te LPP, e nder tjera perfshihen edhe devijimet e vogla ne te cilat eshte ne diskrecion te plote te AK, e sidomos kur ne kete rast ankuesi ka rezultuar si i papergjegjshem.

Andaj, duke marrë parasysh gjithashtu nenin 104, paragrafi 4 i Ligjit për Procedurat e Prokurimit Publik (LPP), i cili përcakton se "Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara, Organi Shqyrtues i Prokurimeve (OSHP) duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë parasysh pasojat e mundshme të veprimeve ose masave të ndërmarra, duke vlerësuar të gjitha interesat që mund të dëmtohen, përfshirë interesin publik," mund të themi se është e rëndësishme që masat e ndërmarra të jenë të balancuara dhe të mbrojnë interesat e të gjitha palëve të përfshira, duke siguruar që çdo veprim të mos ndikojë negativisht në realizimin e projektit apo në interesin publik.

Kjo do të thotë se OSHP duhet të vlerësojë me kujdes ndikimin që mund të ketë çdo masë ose vendim në situatën aktuale dhe të sigurojë që të ruhet ekuilibri mes respektimit të kërkesave ligjore dhe mbrojtjes së interesit publik, pa i shkaktuar dëm procesit të zhvillimit të projektit apo palëve të përfshira. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e pjesshme te ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet vetëm si pjesërisht e bazuar mirëpo Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjakovës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Zgjerimi dhe rregullimi i rrugës Tranziti i

qytetit me numër të prokurimit 632-24-8521-5-1-1 duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim duke u nisur nga fakti se edhe eksperti në raportin e tij ka potencuar se OE ankues nuk ka plotësuar kërkesat e DT si dhe për arsyet e elaboruara nga PSH si më sipër në këtë vendim mbështetur në dokumentacionin e ofruar nga OE ankues.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicioj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: